

PROJEKTI: INFORMACIONI GJEOHAPËSINOR, PËR NJË ZHVILLIM
TË QËNDRUESHËM TË TOKËS NË ZONËN TIRANË-DURRËS

MANUAL

VERIFIKIMI NË TERREN DHE PËRFUNDIMI NË TERREN (V. 1)

MAJ 2020

GRUPI I PROJEKTIT JICA

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	MANUALI PËR STANDARDIN E PUNIMEVE TË TERRENIT.....	1
1.1.	Qëllimi i këtij manuali.....	1
1.2.	Elementë të rëndësishëm	1
1.3.	Skema e procesit të punës	2
1.4.	Të dhëna.....	2
1.5.	Gjuha	2
1.6.	Përgatitja.....	2
1.6.1.	Të përgjithshme	2
1.6.2.	Mbledhja e informacionit lidhur me të dhënat	3
1.6.3.	Konfigurimi i shtresave të informacionit në hartën e punës së terrenit	4
1.6.4.	Interpretimi pararak i fotove ajrore	4
1.7.	Puna në terren	5
1.7.1.	Elementët e konsiderueshëm gjatë punës në terren.....	5
1.7.2.	Kontrolli	6
1.7.3.	Inspektimi.....	7
1.8.	Përfundimi (Finalizimi).....	7
1.9.	Kontrolli i cilësisë	8
2.	VERIFIKIMI NË TERREN.....	8
2.1.	Të përgjithshme.....	8
2.1.1.	Përcaktimi.....	8
2.1.2.	Proceset.....	8
2.2.	Metoda e zbatimit	9
2.2.1.	Planifikimi	9
2.2.2.	Interpretimi paraprak.....	9
2.2.3.	Verifikimi në terren	9
2.3.	Manuali i punës për verifikimin e terrenit me “QField”	10
2.3.1.	Pajisjet që do përdoren.....	10

2.3.2.	Përgatitja	10
2.3.3.	Shpërndarja (Deployment).....	17
2.3.4.	Puna në terren (mbledhja e të dhënave).....	18
2.3.5.	Përpilimi i të dhënave në zyrë.....	22
3.	PËRFUNDIMI NË TERREN	24
3.1.	Të përgjithshme.....	24
3.1.1.	Përcaktimi.....	24
3.1.2.	Proceset.....	24
3.2.	Metoda e zbatimit	24
3.2.1.	Planifikimi	24
3.2.2.	Përfundimi në terren.....	25
3.3.	Manuali i punës për kompletimin me "QField"	28
3.3.1.	Të dhënat e punës në terren.....	28
3.3.2.	Shtresat vektor	28
3.3.3.	Përcaktimi i fushës së attributeve	29
4.	KONTROLLI I CILËSISË.....	31
4.1.	Para përfundimit të punës.....	31
4.2.	Inspektimi	31
4.3.	Sasia e inspektimit.....	31
4.4.	Vlerësimi (gjykimi)	32
5.	MENAXHIMI I PUNËS PËR BURIMET E JASHTME	33
5.1.	Parashikimi i punës që duhet të realizohet ose jo nga burimet e jashtme	33
5.2.	Përzgjedhja e kontraktorit.....	33
5.3.	Të dhënat (elementët) për tu mbledhur.....	33
5.4.	Metoda e mbledhjes së të dhënave dhe specifikimet për dorëzimin e produktit.....	34
5.5.	Takimet teknike dhe shabllonet e punës së terrenit.....	34
5.6.	Prezantimi i produktit.....	35
5.7.	Progresi i procesit të menaxhimit.....	36
5.8.	Inspektimet krahasuese	37

5.9.	Inspektimet përfundimtare të pranimit.....	38
------	--	----

1. MANUALI PËR STANDARDIN E PUNIMEVE TË TERRENIT

Në procesin e krijimit të hartës duke përdorur fotografitë ajrore apo imazhet satelitore (në vijim do përdoret fjala imazhe), është e vështirë të identifikohet saktë informacioni vetëm nga imazhet. Për shembull, disa herë tipologjitë e terrenit nuk janë qartësisht të dallueshme nga imazhet, ose forma ose gjatësia/gjerësia e tipologjisë nuk mund të dallohet kur mund të jenë të fshehura pas një objekti ose poshtë pemëve. Megjithatë, emërtimet e shërbimeve/vendodhjes dhe vijave të kufijve administrativë nuk paraqiten dot në imazh. Për këtë arsye "Verifikimi në terren" dhe "Kompletimi i terrenit" (në vijim do përdoret termi Punimet e terrenit) janë të domosdoshme që të identifikohet informacioni që nuk mund të nxirret nga imazhet.

Punimet e terrenit përfshijnë mbledhjen dhe verifikimin e informacionit në terren, ndërsa rezultati i kësaj pune është shumë i rëndësishëm që të prodhohet një hartë e saktë dhe e besueshme. Për këtë arsye, inxhinierët që realizojnë punimet e terrenit kërkohet që të realizojnë punën në mënyrën e duhur (të saktë dhe të besueshme), dhe të jenë të kujdesshëm të mos shkaktojnë mospërputhje për të gjitha tipologjitë (shtresat) e hartës.

Ky manual për standardizimin e punës përshkruan metodat e punës që të gjithë inxhinierët e përfshirë në punimet e terrenit duhet të ndjekin, me qëllim që të realizojnë punën e tyre. Gjithashtu duhet të jetë e qartë që ky manual mund të mos jetë perfekt, pasi realiteti mund të paraqesë raste nga më të ndyshmet që nuk janë përfshirë në këtë manual. Për këtë arsye, dëshirojmë që ky manual të vazhdojë të përmirësohet për burimet njerëzore që përfshihen në punimet e terrenit, duke marrë në konsideratë të gjithë opinionet dhe sugjerimet e palëve dhe përdoruesve të specializuar.


1.1. Qëllimi i këtij manuali

Ky manual për standardizimin e punimeve aplikohet kur ASIG kryen punimet e terrenit për krijimin e hartës.

1.2. Elementë të rëndësishëm

- Punimet e terrenit janë një proces i rëndësishëm, sukcesi i prodhimit të një harte të mirëfilltë varet nga sukcesi i realizimit të punimeve të terrenit.
- Rezultatet e punimeve të terrenit duhet të shënohen dhe të regjistrohen me kujdes sepse rezultatet mund të jenë të papërdorshme nëse ato nuk janë qartësisht të kuptueshme nga inxhinierët në këtë proces.

1.3. Skema e procesit të punës



1.4. Të dhëna

Sistemi i Koordinimit të Referencës (CRS)

CRS	KRGJSH (bazuar në VKM Nr. 669/2013 ndryshuar Nr.322/2016)
Referenca Elipsoidi (Spheroid)	GRS80 $a = 6,378,137 \text{ m}$ $f = 1/ 298.257 223 563$
Sistemi i Projektimit	Zonal Transverse Mercator (TMzn)
Sistemi Koordinativ Horizontal	Origjina e koordinatave: Kryqëzimi 20 gradë gjerësi lindore dhe ekuator. Koordinon në origjinën: E = 500,000.00m N = 0.00m Faktori i shkallës: 1.0000 në meridianin qëndror
Sistemi Koordinativ Vertikal	Niveli mesatar i detit Adriatik

1.5. Gjuha

Përmbajtja e të dhënave (shënimet) e punëve do jenë në Shqip.

1.6. Përgatitja

1.6.1. Të përgjithshme

- A) Akomodimi: Kërkoni dhe rezervoni një hotel pranë zonës së punës ose përgatitni pajisjet dhe ushqimet për kamping nëse nuk ka hotele të vlefshme.
- B) Autoritet përgjegjëse: Bëni një listë me adresat dhe personin përgjegjës të zyrave shtetërore ose zyrave jopublike që të vizitohen me qëllim informimin dhe parapërgatitjen që ju po i vizitoni.

- C) Leja: Nëse kërkohet leje për punimet e terrenit, bëni kërkesat e nevojshme drejtuar institucioneve përkatëse para se të filloni punimet në terren. Pasi të merrni lejet e nevojshme, vendosni në dijeni stafin e punës dhe jepjani atyre me qëllim që ato të jenë të pajisur me leje gjatë gjithë kohës në terren.
- D) Hartat: Përgatitni hartat e mëposhtme për ti përdorur në terren.
- Hartën e punimeve të terrenit (faqe harte që përmban kufijtë dhe emërtimet administrative/ rrugët/ lumenjtë/ qytetet e mëdha etj.) që të lokalizoni tipologjitë që keni në objektin në terren.
 - Nëse është e nevojshme, hartën e rrjetit të linjave elektrike (printimi i linjave të transmetimit të kërkuara nga dokumentat hartat apo foto interpretimet e mëparshme.)

E) Pajisjet dhe materialet: Përgatitni materialet e mëposhtme.

Lista e pajisjeve
Telefonat
Tabletat e pajisura me GPS dhe funksionin e kameras. Softi i GIS dhe shtresat e hartave të punës duhet të instalohen në pajisjet e tableteve. (Referohu detajeve Error! Reference source not found.)
Harta e rregullave të simboleve
Hartat
Çantat e punës dhe të shpinës
Jelekët e sigurisë
Makinat/Shoferët

1.6.2. Mbledhja e informacionit lidhur me të dhënat

Informacioni i paidentifikuar nga foto interpretimi, psh: kufijtë administrative dhe pikat gjeodezike të kontrollit apo informacionet ekzistuese duhet të mbledhen nga autoritetet (institucionet) përgjegjëse. Në përgjithësi informacionet e mëposhtme kërkohen:

Informacion
Kufijtë administrativ (Emërtimet dhe Kufijtë administrativ)
Zonat e kufizuara (Parqet Natyrore dhe Rezervuarët)
Rrugët (Emërtimi dhe kategoria)
Linjat e tensionit (Transmetimet, Tensioni i Lartë/Mesëm)
Tubacionet (Naftë, Gaz, Ujra)
Pikat e kontrollit gjeodezik (Koordinata, kuota, emërtimin dhe kategorinë)

Kontrolloni informacionin e mbledhur nëse ato mund të përdoren ashtu sic janë ose duhen të inspektohen në

teren.

1.6.3. Konfigurimi i shtresave të informacionit në hartën e punës së terrenit

Para mbledhjes së të dhënave për tipologjitë që kemi objektiv, paraprakisht duhet të krijohen shtresat e hartës që do përdoren dhe të vendosen në aplikacionin GIS. Për më tepër imazhet e realizuara duhet të jenë si një hartë bazë për aplikacionin GIS gjatë punës në terren

Të gjitha shtresat duhet tu përcaktohet dhe tu vendoset Referencë Sistemi Koordinativ (CRS) i duhur sipas Specifikimet Teknike të Produktit për Krijimin e të Dhënave Gjeohapësinore¹

<Shtresat e kërkuara>

Shtresat për punimet e terrenit	[Point]/[Line]/[Polygon] i ri që të ruaj tipologjitë në terren. [Point]: Tipologji pikë. Emërtimet e shërbimeve [Line]: Tipologji linjë. Lumë/Rrugë/Hekurudhë [Polygon]: Tipologji poligon. Park/Varrezë
Shtresat e interpretimit paraprak	[Polygon-Shtresë] Krijuar nga interpretimi paraprak.
Shtresat ekzistuese referencë	[City-name]/ Emërtimi i qytetit ose [Town-name]/Emërtimi i fshatit [Road]/Rrugë [Administrative boundary]/Kufijtë administrativ [Old Topographic map]/Hartat topografike të vjetra
Shtresa me Gridin e hartës	[Grid layer]/Gridi i zonës së studimit që do hartografohet. Kuadratet e gridit duhet të jenë të numërtuar respektivisht
Imazhet	Orto imazhet që mbulojnë të gjithë zonën e studimit.

1.6.4. Interpretimi pararak i fotove ajrore

Para se të shkoni në terren, është e nevojshme të realizohet foto-interpretimi paraprak me qëllim që: 1) Të sigurohet punë më efiçente, më pak dublikime dhe progres më të lartë gjatë punimeve të terrenit, 2) Të shmanget mos evidentimi/marrja e tipologjive të domosdoshme, 3) Të kuptohet sasia e punës që duhet të realizohet në terren, 4) Të kontrollohen elementët që duhet të verifikohen në terren.

Krijoni një shtresë poligoni me shënimet përkatëse ku të markoni tipologjitë që duhen verifikuar në terren.

Shënjeni shtresat e interpretimit paraprak, që janë me komente, në hartën e punimeve të terrenit ku të përcaktohen zonat që duhet të verifikohen në terren duke ju referuar tipologjive objektiv.

Objektivi si mëposhtë:

Cilësia e mbledhjes së informacioneve dhe materialeve	Shënjo tipologjitë që nuk janë të qarta nga ana e : pozicionit, mardhënieve, kategorisë së informacionit, në lidhje me informacionin që duam të mbledhim nga terreni (përshkrimi më sipër Error! Reference source not found.). • Pozicionin dhe emërtimin e fshatit, qyrtetit, qarkut, malit, lumit, përroit etj, • Pozicionin dhe lidhjen me linjën e tensionit të lartë, tubacionet etj.
Tipologjitë e pa identifikueshme ose zonat e pa qarta.	Shënjoni të gjitha tipologjitë ose vendet që janë të fshehura nga një tipologji tjetër, ose një vendodhje ku imazhi nuk është i qartë, një vendodhje ku nuk ka asnjë tipologji ekzistuese në terren.

¹ Geospatial Data Product Specification- Specifikimet teknike të produktit për të dhënat gjeohapësinore (DPS)

	<ul style="list-style-type: none"> • Rrugë ose shteg, urë, tunel, ndërtesë ose tipologji të tjera që ndodhen poshtë një peme ose një tjetër ndërtese. • Zona specifike (varrezat, parqet, shkollat, zona religjioze etj) që ndodhen në zonat e pyjeve. • Drejtimi i rrjedhës së lumit. • Vendet që nuk kanë asnjë tipologji në terren, identifikoni dhe regjistroni "Asnjë tipologji" ose "Asnjë tipologji objektiv" • Punimet e terrenit duhet të performojnë jo vetem mbledhjen e tipologjive e terrenit por edhe verifikimin e situatave "Asnjë tipologji" ose "Asnjë tipologji objektiv"
"Ndryshimet" që mund të jenë bërë pasi është realizuar fluturimi.	<p>Shënjoni zonat e "Ndryshimeve topografike" në krahasim me situatën aktuale ose bazuar në informacionin e shpallur publik.</p> <p>Megjithatë, nëse periudha e informacionit hartografik është e specifikuar si "Koha e realizimit të matjeve", markimi i zonave "Të ndryshuara" nuk është e kërkuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndërtesat komplekse, fabrikat apo zonat në zhvillim në shkallë të madhe. • Rrugët e reja.
Përputhshmëria e secilit informacion	<p>Shënjoni tipologjitë në rast se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të gjithë tipologjitë që ekzistojnë sipas informacionit të mbledhur (përshkrimi në 1.6.2 më sipër): • Nëse tipologjia nuk shfaqet në imazh, gjejini dhe identifikojeni në terren. • Nëse tipologjia e re që ndodhet në të njëjtën kategori por nuk ekziston në informacionin ekzistues të mbledhur, identifikojeni si tipologji të re. • Një tipologji e emërtuar në informacionin e mbledhur në terren është ndryshe nga emërtimi i të njëjtes tipologji në hartat topografike ekzistuese.

1.7. Puna në terren

Punimet e terrenit duhet të realizohen për të gjithë tipologjitë e specifikuara në materialin DPS si: rrugë, rrjedha ujore, hekurudhat, strukturat, facilitetet dhe kufijtë e vegjetacionit.

1.7.1. Elementet e konsiderueshëm gjatë punës në terren

Informacionin e tipologjive që kemi si objektiv duhet të mblidhet me kujdes dhe të rregjistrohen sipas standardit DPS, me qëllim që të përdoret në mënyrë korrekte në proceset vijuese. Rregjistroni informacionin e tipologjive duke përdorur numrat apo kodet specifike të hartës, me kujdesin që mos të bëhen gabime. Ndryshe, kur gjeni një element që nuk është përshtatshëm me tipologjitë specifike që synojmë të krijojmë, markojeni dhe bëjini një foto të këtij elementi. Pastaj në zyrë, shikoni nëse duhet konsideruar për t'u përfshirë në hartë dhe në cilën tipologji do të bëjë pjesë.

Konsiderata të përgjithshme për procesin e punës në terren.

- A) Ndryshimet kohore: me që ekzistojnë ndryshime në kohë të procesit të fotografimit dhe punimeve të terrenit, duhet që të gjykohet me kujdes cilat mund të jenë ndryshimet e bëra gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu ka diferencë në kohë edhe për periudhën e punimeve të terrenit dhe krijimit të situacionit në terren si ndërtimi i rrugëve të reja, hekurudhave, po ashtu ndryshimet topografike nga ndërtimet e objekteve, prerjes së pemëve apo katastrofave. Megjithatë, këto tipologji në ndryshim duhet të merren në konsideratë nëse duhet të mblidhet si informacion ose jo duke zbatuar në "kohën e

marrjes së informacionit të imazheve”.

Koha e marrjes së informacionit hartografik	Gjykimi në punën në terren kur ka "Ndryshime" në terren
Në Kohën e fotografimit	Nuk është e nevojshme të mblidhet informacion të tipologjive që janë në "Ndryshim"
Një datë specifike pas fotografimit ajror (=në fillim të procesit të punës në terren)	Mblidhet informacioni i tipologjive që konsiderohen si në "Ndryshim" Kur shkalla e ndryshimit është e madhe duhet të ndërmerret një fushatë matje topografike me GNSS ose Stacion Total apo fotografim ajror tjetër vetëm për zonën e ndryshuar.

- B) Ndryshimet artificiale: Ekzistojnë disa ndryshime mes hartave të punimeve të terrenit dhe situacioneve të terrenit gjatë ndërtimeve të rrugëve të reja, hekurudhave dhe strukturave pas realizimit të fotografimit, po aq sa ka ndryshime topografike gjatë ndërtimit të objekteve, komplekseve, prerjeve/mbjelljeve të pemëve apo katastrofave.
- C) Hijet: Ka ndryshime mes hijeve në hartat e punimeve të terrenit dhe situacionit sepse në sezona të ndryshme ka ndryshime në hije.
- D) Pjesët e fshehura: Kërkohej që të kontrollohen vazhdimet dhe pozicionet e rrugëve, shtigjeve, përrenjëve në male dhe rrjedhjeve ujore sepse ato nuk mund të interpretohen lehtësisht në hartat e punimeve të terrenit. Kontrolloni gjithshashtu edhe drejtimin e rrjedhës së ujit në terren.
- E) Shkrimet: Paraqitni të gjithë shkrimet e shërbimeve publike në princip. Kontrolloni emërtimet trupave administrative dhe terrenit natyral referuar informacionit zyrtar nga institucionet përgjegjëse lokale. Shikoni bashkëngjitur tabelën "Punimet e terrenit dhe standardi i vendosjes së shkrimeve"

1.7.2. Kontrolli

Punonjësit e terrenit, duhet të kontrollojnë rezultatet e punës së tyre pas përfundimit të procesit të punës në terren dhe para se të largohen nga terreni, në mënyrë që të gjendet ndonjë mospërputhje apo gabim që mund të rregullohet menjëherë.

Cilësia e punimeve të terrenit duhet të sigurohet nga kontrolli i përmbajtjes duke përdorur informacionin e regjistruar si mëposhtë:

Mungesat/Shtesat	Ndonjë tipologji e pa specifikuar
	Ndonjë sipërfaqe e pa mbyllur.
	Ndonjë element i panjohur.
Klasifikimi	Ndonjë mosklasifikim
	Ndonjë numër-kod të pa specifikuar
Pozicioni/Figura	Ndonjë mospozicionim
Shprehja/Drejtshkrim	Ndonjë gabim drejtshkrimor
Vlefshmëri	Ndonjë përgjigje e pa saktë

1.7.3. Inspektimi

Inspektimi duhet të realizohet me anë të metodës së inspektimit krahasues (duke ndjekur të njëjtën metodë me punimet e terrenit në ndonjë sipërfaqe të përcaktuar.

Cilësia dhe zona e inspektimit përcaktohet nga një inspektues që varet nga kushtet e projektit (duke mbajtur në konsideratë afatet dhe vendodhjen ku implementohet)

1.8. Përfundimi (Finalizimi)

Me qëllim që informacioni i mbledhur nga punimet e terrenit të shpërndahet lehtësisht dhe të kuptueshme me operatorët në procesin vijues, rezultate duhet të jenë të mirë organizuara:

- A) Fshini të gjitha gjetjet. (Kodin e tipologjisë, koordinatat, shënimet, fotot), Fshini informacionin e panevojshmëm të përjashtoni çdo lloj konfuzioni.
- B) Kontrolloni shkrimet (Kodet, numrat dhe emërtimet) sipas drejtshkrimit dhe alfabetit specifik. Të gjithë informacionet e shkrimeve duhet kontrollohen zyrtarisht.
- C) Sistemoni të gjithë informacionin e mbledhur nga autoritet përgjegjëse. Vendosni Numrin e koduar të secilës tipologji mbështetur në rregullat e DPS, me qëllim që informacioni të përdoret lehtësisht për prodhimin e hartës
- D) Krijoni dokumenta shpjegues (manual, përdorues) që të ndihmoni operatorët të kuptojnë elementët e rëndësishëm ose shënimet e punimeve të terrenit. Për shembull:

- Shpjegimi i të dhënave të punimeve të terrenit (Emërtimet e shtresave / tabela e përmbajtjes)
"Shkrimet, informacioni mbi emërtimet e shërbimeve i përket shtresës GN-Emërtimeve gjeografike"
"Shkrimet, emërtimi shërbimit ruhet në kolonën e atributit NamedPlace – Emërtimi i vendit"
"Kodi i regjistruar me numrin 99999 i përket tipologjive me kategori të papërcaktuar"
- Nëse linjat e vizatimit të të dhënave të punimeve të terrenit (p.sh. forma e rrugës ku është e paqartë në figurë) janë saktësi të mjaftueshme për t'u përdorur direkt për prodhimin e hartës (për tu vizatuar me saktësi me gjatësi me matje), ose është thjesht një saktësi referuese (për tu vizatuar afërsisht).
"Përvetësoni linja të sakta me anë të interpretimit të fotografive sepse linjat e vizatimit të të dhënave në punimet e terrenit nuk janë të sakta në pozicion. Këto linja vizatimi tregojnë vetëm kategorinë e veçorive. "
- Tipologjia me komentin "Road end" tregon që është "Mbarimi i rrugës" në atë pozicion, nuk vazhdon më tej rrugë e aksesueshme."
- Në shapefile-in e të dhënave të punimeve të terrenit, përdorni simbolin "\$" në vend të shkronjës "E", ndërsa simbolin "#" në vend të "Ç". Këto simbole "\$"/"#" duhet të zëvendësohen me shkronjat me shkronjat "E"/"Ç" në fund. Ky veprim bëhet për të shmangur gabimet e mundshme në gjuhën e programimit të shapefile-it kur përdoren karaktere speciale.

1.9. Kontrolli i cilësisë

Kontrolli i cilësisë, KC si shkurtim, shërben për të vlerësuar cilësinë e secilit proces në prodhimin e hartës dhe për tu siguruar që cdo element është krijuar brenda tolerancës së caktuar.

Fletët e kontrollit të cilësisë që regjistrojnë rezultatet dhe saktësinë e inspektimit paraqesin cilësinë për secilin proces. Metoda më e përshtatshme për punimet e terrenit është ajo e ri-verifikimit: Një inxhinier që nuk ka qenë i përfshirë në grupin e punës, shkon në terren i pavarur nga puna e mëparshme dhe kontrollon dhe krahason rezultatet.

Megjithatë, meqë është e vështirë të bësh ri-verifikimin e të gjithë zonës apo realitetit, cilësia e punimeve të terrenit duhet të realizohet duke kontrolluar një inspektim si ai i përshkruar më sipër në 1.7.2 dhe 1.7.3.

2. VERIFIKIMI NË TERREN


2.1. Të përgjithshme

2.1.1. Përcaktimi

“Interpretimi paraprak” është për të identifikuar të gjitha tipologjitë që duhet të verifikohen, të studiohen dhe/ose maten gjatë verifikimit në terren. Kjo punë do të kryhet në zyrë, duke përdorur ortofotot dhe materialet ekzistuese siç janë hartat topografike dhe kështu me radhë, para verifikimit në terren.

“Verifikimi në terren” është për të verifikuar, konfirmuar dhe korigjuar tipologjitë të cilat janë identifikuar gjatë para-interpretimit dhe/ose grumbullimi i tipologjive të cilat nuk janë identifikuar por specifikohen në DPS.

2.1.2. Proceset



2.2. Metoda e zbatimit

2.2.1. Planifikimi


Aktivitetet e mëposhtme duhet të realizohen.

- Kontrolloni nëse imazhet që do të përdoren për verifikimin në terren mbulojnë të gjithë zonën e projektit.
- Planifikoni paraprakisht një rrugë studimi.
- Programi i punës dhe formimi i grupit: Planifikoni një program pune dhe formimin e grupeve për të siguruar përfundimin e punës si verifikimi në terren dhe finalizimi i të dhënave para afatit të specifikuar. Në programin e punës, përfshini ditët që janë të nevojshme për përgatitjen e punës, para-interpretimin për verifikimin në terren, verifikimin në terren, pushimet dhe finalizimin e të dhënave.
- Nga pikëpamja e menaxhimit të sigurisë së punës, mos planifikoni një program të pa arsyeshëm.

2.2.2. Interpretimi paraprak

Para daljes në terren, punimet e mëposhtme duhet të realizohen në zyrë, kjo quhet interpretimi-paraprak.

- Shtoni shënime për tipologjitë e "NamedPlaced" duke iu referuar materialeve ekzistuese si hartat topografike dhe kështu me radhë.
- Për tipologjitë e "GovernmentalService (p.sh., generalHospital)" ose "AsigPointReligiousFeature (p.sh. mosque)" duke iu referuar hartave ekzistuese topografike, shënioni ato me pikë ose vijë.
- Për tipologjitë që nuk janë të qarta në ortofoto, shënioni me pikë ose vijë.




2.2.3. Verifikimi në terren

Punimet e terrenit fillojnë pasi përfundimit me sukses të procesit planifikimit dhe interpretimit paraprak.

- Mblidhni tipologjitë që nuk u gjetën ose u identifikuan gjatë interpretimit paraprak dhe futeni në "Shtresat e verifikimit në terren" ("Field verification layers") me pikë ose vijë.
- Mblidhni edhe shënime për tipologjinë e "NamedPlaced" duke i referuar tabelave të shenjave etj.
- Shkrepni fotografi për çdo tipologji që verifikohet, korrigjohet, grumbullohet dhe/ose modifikohet në

terren si dëshmi e punës dhe lidh fotot me gjeometrinë. Sidomos për tipologjitë që ekzistojnë nën pemë dhe/ose që nuk janë të dukshme në ortofoto, merrni disa foto nga kënde të ndryshme.



2.3. Manuali i punës për verifikimin e terrenit me “QField”

2.3.1. Pajisjet që do përdoren

Pajisjet e mëposhtme duhet të përgatiten në vijim:

Hardware	<ul style="list-style-type: none"> ● Android Tablet ● Note PC
Software	<p>a) QField https://www.qfield.org/</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikacioni Android i QGIS veçanërisht për grumbullimin e të dhënave në terren - Versioni 0.10.13 – Kesch - Shkarkimi dhe instalimi i QField nëpërmjet GooglePlay https://play.google.com/store/apps/details?id=ch.opengis.qfield <p>b) QGIS https://qgis.org/en/site/</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorur gjerësisht OSS Desktop GIS - Versioni: 2.18.22 (Versioni i lëshuar afatgjatë (më i qëndrueshëm), që nga 11 Gushti) - Shkarkimi dhe instalimi i QGIS nëpërmjet https://www.qgis.org/en/site/forusers/download.html

2.3.2. Përgatitja

(1) QGIS/QField project file *Reference: <https://www.qfield.org/docs/index.html>

Menaxhimi i Projektit

QField nuk ka një menaxhim të projektit të integruar. Është e nevojshme që fillimisht të krijoni dhe konfiguroni projektin nga QGIS dhe pastaj të kopjoni skedarin e projektit (.qgs) dhe çdo skedar shtesë në pajisje dhe hapeni atë me QField.

Projekti Portativ

Nevojitet një version portativ i skedarit të projektit QGIS (.qgs). Portativ do të thotë që të gjitha shtigjet janë relative dhe grupet e të dhënave janë të arritshme nga pajisja.

Kontrolloni në Project ► Project Properties ► General ► Save shtigjet janë vendosur në "Relative" dhe që të gjitha skedarët e të dhënave të kërkuara duhet të ruhen në të njëjtën dosje ose nëndosje me skedarin .qgs.

(Shembull)

\FieldVerification: (Direktoria)


Demonstration.qgs: (Skedari i Projektit)

\ThematicData_Vector: (Shtresat/Grupet e të dhënave që do mblidhen në terren)


\Background_OrthoPhoto: (Imazhi i ortofotos si fushëpamje "Background")

\Index: (Sipërfaqja e punës që synojmë)

\DCIM: (Fotot e terrenit do të ruhen)




[Demostrim] Startoni QGIS-in duke klikuar dy herë mbi "Demonstration.qgs"




(2) Vendosni Sistemin Koordinativ Reference "CRS"

Shkoni tek [Project>Project Properties>CRS] dhe selektoni ETRS / Albania TM2010 EPSG6870.




(3) Modelet e shtresave

QGIS




Windows Explorer

`\\FieldVerification\ThematicData_Vector`



- Të dhënat e punës në terren (Fieldwork data)

Punimet e terrenit përmbajnë informacionin e mëposhtëm dhe ruhen në tableten "Android".



- Përmbajtja e atributëve

Secili "shapefile" në "ThematicData_Vector", ka atributet e mëposhtme.

Line.shp

FID	Descriptio	Photo1 – Photo6	code
Feature ID	Description	Photo filename	Attribute value code

Point.shp

FID	Descriptio	Photo1 – Photo6	code
Feature ID	Description	Photo filename	Attribute value code

NamedPlace.shp


FID	GN	Descriptio	Photo1 – Photo6	code
Feature ID	Geographical name	Description	Photo filename	Attribute value code

Agri&AquaBuilding&Installation.shp

FID	Descriptio	Photo1 – Photo6	code
Feature ID	Description	Photo filename	Attribute value code

(4) Krijimi i shtresave të terrenit

Shkoni tek [Layer > Create Layer > New Shapefile Layer] dhe krijoni të dhëna të reja vektor.



Konfiguroni Shapefile-in sipas Specifikimeve

Selektoni llojin e gjeometrisë

Emërtimi i fushës


Selektoni CRS

Shtoni një fushë të re

Klikoni OK për ta ruajtur

Shënim: Gjatesia Maksimale e "field name" është 10 karaktere.

Klikoni me të djathtën mbi shtresën që duam "Layer > [Properties]", pastaj shkoni te [Fields tab > klikoni butonin "Toggle editing mode" > klikoni "New field" > Shtoni një emërtim të fushës dhe konfiguroni atë.




(5) Krijimi i shtresave të Punimeve të terrenit


Konfiguroni fushat (Configure fields)

Editoni konfigurimet “widget”


- Text Edit : për të edituar vlerat e informacionit tekst p.sh përshkrimet, emërtimet e shërbimeve
- Value map: vendosni vlerat opsionale të selektueshme
- External Resource: vendos funksionet e kamerat në tablet



“Value Map”: bën të selektueshme për përdorim vlerat e kodeve




“External Resource” aktivizon “Photo/Camera function” në QField



(6) Të dhënat e sfondit (Background data)

Vendos fushëpamjen “background-in” duke përdorur imazhet e ortofotos si mëposhtë.

\\FieldVerification\Background_OrthoPhoto\sample_Tirana



[Këshilla]

- Karakteristikat e shtrësive: Të identifikueshme, të lexueshme, etc
- Në QGIS, Project > Project Properties > Identify Layers
- Bejini "Backup" projektit rregullisht dhe shpesh
- Karakteristika e kodeve/vierave janë të ruajtura në skedarin e projektit dhe jo në shapfile. Nëse këto karakteristika humbin apo dëmtohen për ndonjë arsye, do ju kërkohet të ribëni të njëjtat konfigurime.

2.3.3. Shpërndarja (Deployment)

(1) Kopjoni

Kopjoni skedarin e projektit dhe të gjitha të dhënat/dosjet e nevojshme në tabletin Android


- Lidheni një tablet me kompjuteri nëpërmjet USB
- Kopjoni dosjen "FieldVerification" në direktorinë e mëposhtme:

{SDCard}\Android\data\ch.opengis.qfield\files\


Në mënyrë që të keni akses të rregullt me projektet që janë në kartën e jashtme SD, është e nevojshme të të vendoset në folder-in e mësipërm.

(2) Hapni një projekt

Startoni QField në tabletën Android, shkoni [Option > Open Project], navigoni tek një skedar “.qgs” dhe hapni një projekt.




Shpërndarja e suksesshme.




2.3.4. Puna në terren (mbledhja e të dhënave)

Funksionet që do përdorni gjatë mbledhjes së të dhënave përshkruhen si mëposhtë:

Show layer - Shfaqni shtresat




View attributes - Shfaqni atributet



Edit layer/data – Editoni të dhënat e shtresës



Edit layer/data – Editimi i të dhënave të shtresës: Beni një foto




[NOTE]

- Fotografia e terrenit do të jetë formati JPEG, madhësia e portretit.
- Fotografia e terrenit do të merret më shumë se 2448 * 3264 piksela dhe 72 dpi.
- Shkrepi një fotografi të tërë pamjes së tiparit të synuar në një foto.
- Përfundimisht, fotografitë shitesë mund të merren nga drejtime të tjera ose në pamje zoom.






[Këshilla]

- "Paneli i informacionit" ("Info panel") në anën e djathtë mund të fshihet duke klikuar butonin "mbrapa" ("back") në pajisjen android.



Funksioni GPS / Paraqet pozicionin aktual (i vlefshëm edhe pa internet)



2.3.5. Përpilimi i të dhënave në zyrë

Informacioni i mbledhur përmes punës në terren (Verifikimi në terren / Përfundimi në terren) duke përdorur QField në tabletin Android, duhet të merret për punën e mëvonshme, siç është procesi i "plotting/editing", si një informacion referimi.

Për të kaluar informacionin e terrenit pa keqkuptime tek operatori, të dhënat e punës në terren duhet të konvertohen nga formati i koduar në informacione të lexueshme.



(1) Shkarkimi (Download)


Shkarkoni të gjitha të dhënat apo folder-at e nevojshëm të punimeve të terrenit nga tableti

Në kushtet e "Data backup", shkarkimi dhe ruajtja e punës duhet të realizohet cdo ditë pas përfundimit të punës

1. Lidhni tabletin me një kabëll USB me kompjuterin.
2. Hapni dosjen "FieldVerification" në direktorinë përkatëse mëposhtë:

{SDCard}\Android\data\ch.opengis.qfield\files\

Kopjoni dosjet "DCIM" dhe "ThematicData_Vector" në kompjuterin tuaj.



(2) Konverto vlerat e koduara

Informacioni i "shape file" i siguruar në terren ka vetëm vlerë të koduar.

Për operatorin e procesit të "plot/editing" është e vështirë të vizatojë ose ndërhyjë, ndërsa identifikon dhe klasifikon vizualisht kuptimin e vlerës së koduar.

"Çfarë lloj tipologjie u sigurua, ose çfarë u vizatua mbi vijë?"

Është e nevojshme të konvertohet vlerat e koduara në vlerën e vargut të lexueshëm në mënyrë që operatori të mund të punojë normalisht.

Në software-in GIS si ArcGIS/QGIS, ka një funksion të "Join" që mundëson lidhjen e tabelës attributeve të "shape file" dhe të dhënave të jashtme në tabelë.

Formati i skedarit CSV, është përdorur në përgatitjen e QGIS/QField në mënyrë që të mundësohet "Selectable option" në QField, që mund të përdoret për konvertimin.



[Këshilla]

Në rast se dosja DCIM, e cila ruan fotot e marra në QField, nuk shfaqet në dosjen në Windows Explorer, ju lutemi provoni të merrni dosjen e fotografive përmes lidhjes WiFi.

1. Lidhni kompjuterin dhe tabletën me të njëjtën WiFi
2. Në tabletën Android, selektoni File Manager > PC file transfer > start
3. Aksesoni URL e paraqitur në tabletën Android nëpërmjet çdo browser-ri në kompjuter, pastaj navigoni në direktorinë e mëposhtme:
[0123-4567>Android>data>ch.opengis.qfield>files>FiledVerification](#)
4. Duhet të gjeni dosjen "DCIM". Klikoni me të djathtë, kompresojeni dhe shkarkojeni atë.
5. Vendosni dosjen DCIM brenda dosjes "FieldVerification" kështu që softi QGIS mund ta identifikojë vendodhjen e fotove nëpërmjet adresës relative të dosjes "FieldVerification", ose mund ta vendosni brenda çdo dosje tjetër e cila ka një adresë relative (relative path) të konfiguruar në softin QGIS.

3. PËRFUNDIMI NË TERREN


3.1. Të përgjithshme

3.1.1. Përcaktimi

“Përfundimi në terren” do të thotë që shprehja në hartën e tipologjive topografike dhe emri i tyre do të rikonfirmohet në zonën e paqartë në mënyrë që të kompletohet harta topografike.

Rezultatet e rikonfirmimeve do të shprehen në hartën topografike dixhitale të vizatuar (digital plotted topographic map) për përfundimin në terren për të përgatitur materialin e nevojshëm (dokumentet dhe të dhënat) për përpilimin dixhital pas përfundimit në terren.

3.1.2. Proceset



3.2. Metoda e zbatimit

3.2.1. Planifikimi

Aktivitetet e mëposhme duhet të realizohen:


- Kontrolloni nëse imazhet që do të përdoren për përfundimi në terren mbulojnë të gjithë zonën e projektit.
- Planifikoni paraprakisht një rrugë studimi.
- Programi i punës dhe formimi i grupit: Planifikoni një program pune dhe formimin e grupeve për të siguruar përfundimin e punës si përfundimi në terren dhe finalizimi i të dhënave para afatit të specifikuar. Në programin e punës, përfshini ditët që janë të nevojshme për përgatitjen e punës, përfundimi në terren, pushimet dhe finalizimin e të dhënave.
- Nga pikëpamja e menaxhimit të sigurisë së punës, mos planifikoni një program të pa arsyeshëm.

3.2.2. Përfundimi në terren

Çfarë është "Përfundimi në Terren" ?

Puna e "Përfundimit në Terren" është për të grumbulluar informacion dhe riverifikuar tipologjitë që janë gjetur të paqarta apo të paidentifikuara gjatë punës së stereo plotting.

Tipologjitë e paqarta apo të paidentifikuara, të treguara nga operatori i stereo plotting (Pyetje) do të sqarohen (Përgjigjen) nga puna në terren (Përfundimi në terren).



Çfarë është "Tipologji e paqartë apo e paidentifikuar"?

"Tipologji e paqartë apo e paidentifikuar" për operatorin është klasifikim i paqartë ose shtrirje/formë/vendndodhje e paqartë, ose tipologji e paidentifikuar (nëse kërkohet për hartën).

Tipi i Pyetjes	Përshkrimi	Komenti nga Operatori "Në imazh, duket ..."
[Kodi]? Është kodi i saktë?	<ul style="list-style-type: none"> ● Klasifikim i dyshimtë ● Nuk është e qartë nëse kodi është i saktë. ● Nuk është e qartë nëse tipologjia kërkohet. 	Duket që klasifikimi është ndryshe nga ai i treguar nga "verifikimi në terren".
[Kodi] apo [Kodi]? Cili kod është i saktë?	<ul style="list-style-type: none"> ● Klasifikim i dyshimtë ● Nuk është e qartë cili kod është i saktë. 	Duket që klasifikimi është ndryshe nga ai i treguar nga "verifikimi në terren".
